



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 34/2010

Prishtinë, 22. 09. 2010, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Fatmir Rexhepi, Mursel Haljilji, Sala Berisha – Shala, Kaqusha Jashari, Adem Grabovci, Qamile Morina, Zef Morina dhe deputeti Emrush Xhemajli.

Munguan: Adem Salihaj dhe Műfera Şinik.

Pjesëmarrës të tjerë: Ibrahim Krasniqi konsulent i Komisionit.

Stafi mbështetës: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Rishqyrtimi i Propozim – Vendimit të Qeverisë për Privatizimin e PTK –së nr. 03 -V-393 datë 27.07.2010;
3. Të ndryshme.

Kryetaria- e Komisionit konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Rishqyrtimi i Propozim – Vendimit të Qeverisë për Privatizimin e PTK –së nr. 03 -V-393 datë 27.07.2010;

Myzejene Selmani – tha që debati është shtjer në mbledhjen e fundit të Komisionit për çështjen e rekomandimeve të Strategjisë së privatizimit të PTK-së, atëherë është e juaja të jepni rekomandimet lidhur me strategjinë e privatizimit të PTK-së.

Fatmir Rexhepi – tha që të jemi më konkret për përgatitjen e rekomandimeve për shkak të mandatit që na dha Kuvendi i Kosovës në seancë, dhe Kryetari i Parlamentit. Propozoj disa rekomandime pastaj që Komisioni të merr vendimin. Andaj bazuar në politikat programore që i kemi biseduar për përcaktimin për ekonomi tregut dhe për të vazhduar reformat lidhur me menaxhimin dhe strukturimin e ndërmarrjeve publike, bazuar në analizat e sektorit të telekomunikacionit konkurrencen, tregun si dhe menaxhimin performancën e dobët të PTK-së për këto 10 vite, bazuar në politika dhe strategjinë për futjen e kapitalit dhe investimeve të huaja përmes partneritetit publiku privat në zhvillimin më të shpejtë ekonomik të vendit, procesi i privatizimit të telekomunikacionit duhet të fillojë me transparencë të plotë dhe me strategji e cila do të mundësojë futjen e kapitalit privat, menaxhimin modern dhe zhvillim të saj në raport me konkurrencën, të rrisë vlerën e kompanisë si dhe në ruajtjen e interesit dhe benefiteve për shtetin përmes aksioneve të mbajtura. Prandaj për përmbushjen e këtyre synimeve i propozoj këto plotësime në strategjinë e Qeverisë për Privatizimin e PTK-së: Kuvendi të perkrah procesin e filluar të privatizimit të PTK-s për sektorin e telekomunikacionit duke bërë ndarjen dhe vlerësimin për Telekom dhe Postën. Kuvendi të lejoj shitjen deri në 59% të aksioneve të Telekomit për privatizim dhe që siguron investitorin privat, kapitalin e tij, duke i mundësuar kontrollimin e menaxhimit dhe të vendimarrjes në kompani për të realizuar strategjinë e zhvillimit të plotë të saj me konkurrencën dhe trendet në tregun e telekomunikacionit. Kuvendi vlerëson se përmes këtij partneriteti dhe investimeve për 3-4 vitet e ardhshme në kompani, vlera e aksioneve të mbajtura (45-49)% nga Qeveria e Kosovës do të rritet me kalimin e kohës bashkë me dividendën vjetore dhe benefitet tjera për Shtetin. Kuvendi obligon Qeverinë që mjetet nga shitja të përdoren për investime kapitale dhe zhvillim ekonomik të vendit. Deri në 50 % të lejohen për infrastrukturë dhe Autostradë, ndërsa mjetet tjera për veprimtari dhe programe tjera zhvillimore. Kuvendi kërkon nga Qeveria të bëjë përgatitjet dhe deri në momentin e shitjes së aksioneve të aplikojë dhe të marrë Kodin e telefonisë për Kosovën e cila do të ndikojë në rritjen e vlerës së PTK-së dhe çmimin e shitjes së aksioneve. Kuvendi kërkon nga Qeveria të mundësojë procesin transparent, pa ndikime politike nga i cili do të varet edhe performanca e kompanive ofruese dhe fituesit të tenderit. Kuvendi kërkon nga

Qeveria që në fazën e caktuar, të njëfotë lidhur me zbatimin e rekomandimeve, ecurinë, transparencën, kontratën si dhe marrëveshjen në mbrojtjen e të punësuarëve në PTK. Thëksoj që këto rekomandime e knaqin planin kohor dinamikë kohorë qoftë për investime qoftë për buxhet qoftë për strategji, ndoshta edhe Qeveria ka kërkuar për shkak se ka miratuar strategjinë buxhetore. Sa i përket përqindjes më të madhe tha që nuk kemi nevojë në këtë moment, pra, ne kemi nevojë për investime për zhvillim jo për nevojë buxhetore të cilat shpeshherë ende nuk e kemi aprovuar atë strategji buxhetore të Qeverisë. Ne duhet të jemi për investime kapital për përdorimin e fondeve poashtu në investime tjera, për politikën e taksave politikën buxhetore politikën financiare mendoj që është një politikë që Qeveria duhet të merret. Prandaj ne si Parlament si Deputet na jep një strategji tjetër, jo ta përdor shpërndarjen e PTK-së për ato nevojë edhe pastaj pas dy apo tri viteve të na dalin probleme tjera. Kjo është arsyeja që e kam përmbledh në këtë dokument edhe kuotën është 55%.

Adem Grabovci – tha që pajtohet me deputetin, këto rekomandime përputhen me rekomandimet që i kam parapa ti propozoj këtu, përveq të aksioneve mendoj që kjo është e diskutueshme dhe duhet të meriton që ne të shqyrtojmë mundësinë dhe interesin tonë a ma shumë po humbim apo po fitojmë më përmbushjen e asaj kuotës së 67%. Personalisht jam i bindur që mospërmbushja e kuotës do të na sjellë më tepër dëme sesa dobi, kur them këtë e kam parasysh se nëse shkojmë në kuotën 55% dhe nuk është ndoshta ndonjë diferencë shumë e madhe megjithatë ne për një përfitim shumë të vogël besojmë se do të humbim investitor shumë më të fuqishëm që do të jenë shumë më serioz në investimet e tyre në zhvillimin e PTK-së, prandaj mendoj se në vend të 55% të paktën ne ta lëjmë të hapur 55 deri në 67% dhe tia lëmë Parlamentin të Kosovës të vendosë me vota. Një problem tjetër që mendoj se nuk është i përfshirë duhet të mendojmë edhe për fatin e puntorëve për një periudhë të caktuar kohorë. Është përmendur ndarja e Postës dhe Telekomit, të shitet Telekomit i Kosovës dhe me një rekomandim të obligohet blerësi që në afatin e caktuar të obligohet blerësi 2 apo 3 vjet sa mendojmë që ta mbajë Postën dhe ta zhvillojë dhe pastaj ti kthehet vendit, ne e dimë se nëse mbetet Posta atëherë duhet që Qeveria e Kosovës nga buxheti i gatshëm të zhvillojë dhe investojë, prandaj edhe kjo të futet të precizohet në rekomandime.

Ethem Çeku – theksoj se përfaqësoj grupin parlamentar dhe në bazë jam me pozicionin e grupit parlamentar, edhe nga ana e opozitës kemi bërë qka është e mundur që procesi i tillë të zhvillohet pavarësisht bindjeve tona a është momenti, kriza ekonomike globale, a është a po krijojmë partner të mirë strategjik apo atë që e kemi ngrit nga fillimi cilat janë benifitet që arrin shteti i Kosovës në raport me privatizimin. Në teorinë e zhvillimit të shtetit, në shumë raste paraqitet zhvillues, shteti Japonëz paraqitet si zhvillues, shteti gjerman paraqitet si zhvillues, dhe shteti që krijon hapësirë për zhvillim ekonomik si SHBA dhe vende të tjera të cilat largohen nga ndërhyrja por në raste të caktuara kur kanë krizë globale Qeveria Amerikane hyn dhe i blen Bankat, i blen Korporatat, jep kredi për ta shpëtuar tregun. Tha jam që rekomandimet të dalin në votim dhe shumica vendos a shkojnë në seancë plenare apo nuk shkojnë, unë besoj që janë shtjerr të gjitha bindjet për të bindë për pro apo kundër, Në fund duhet të them ta shohim shumë mirë apo hyjmë në një favor të zhvillimit ekonomik apo e dobësojmë pozitën e shtetit në kontekstin e zhvillimit ekonomik.

Myzejene Selmani – kërkoj nga Deputeti Zef Morina bazuar në përvojën e tij të japë mendimin dhe plotësimin e tij për rekomandime, tashmë qëndrimi i grupit parlamentar të partisë që i takoj është i njohur për qështjen që po e diskutojmë dhe nuk kisha shtuar më shumë.

Zef Morina – tha se është shumë me rëndësi ndarja e Postës dhe Telekomit në këtë moment duhet me u ditë. Siç është thënë deri 2/3 kanë interes ta marrin PTK-në. Nëse ndahet telekomi prej postës këto 2/3 nuk e kalojnë 51%, këtu është çështja që ne këtë duhet me ditë, ne ja caktojmë Parlamentit a me qenë 51 a me qenë 55 a me qenë 67%, mirëpo nëse i bëjmë keto dy ndarje veq e veq atëherë është shumë lehtë se këto pikat tjera janë të gjitha që janë debatuar, kjo duhet të qartësohet që edhe deputetët mos me qenë në hutë se kur të votohet aty normal që dikush mendon se është e paqartë, kështu që ne duhet me ja bërë shumë të qartë. Nëse vlerësohet veçmas Telekomi edhe Posta vlera e Telekomit në krahasim me vlerën e përgjithshme të PTK-së është 72% e vlerës së përgjithshme. Nëse ne e pranojmë si të tillë me 67% ne e kemi privatizim Telekomit 100% dhe ne skemi kurgje më aty, këtu është problemi.

Kaqusha Jashari – tha se duhet decidiv me qenë që të ndahet Posta dhe Telekomi. Sipas strategjisë Posta jipet për 4 vite për ristrukturim, e pas 4 viteve me u kthyer këtë nuk e di vetëm atje në strategji ekziston, do të diskutojmë a duhet me bërë ristrukturimin në këtë mënyrë me ja dhënë investitorit edhe me kthyer mandej. Është mirë me sqaruar çështjen e punëtorëve dhe mendoj se marrveshja me sindikaten e punëtorëve të jetë pjesë e kontratës me investitorin.

Mursel Halilji – Tha që këto janë investime shumë të mëdha dhe përqindja deri në 75% duhet arsyetuar mirë, ndarja e postës dhe telekomunikacionit nuk është e qartë. Andaj duhet të angazhohet një kompani konsulentë që të na jap sqarime më të hollësishme. Pastaj ne si komision funksional e kemi më lehtë që t'i propozojmë rekomandimet për Kuvendin dhe që të jenë në strategjinë e Qeverisë për privatizimin e PTK-së.

Qamile Morina – tha se çështjet kaq e rëndësishme kapitale të diskutohen pa ndonjë sqarim të mirë cili është epilogu nuk është në rregull. Ne e dimë për ndërmarrjet shoqërore askush se ka dhënë përgjegjësinë se ka qenë e udhëhequr nga ndërkombëtarët. Kësaj radhe adresa dihet për përgjegjësi nëse puna nuk do të shkon mirë. Konsideroj që për Komisionin është shumë barrë e madhe të vendosë për një çështje të tillë dhe qëndroj pranë asaj të mos diskutohet 55% apo 75% kjo është ka më duket jashtë çdo profesionalizmi, jashtë çdo niveli jashtëzakonisht të rëndësishëm shtetëror. Mendoj që kjo çështje duhet me u krye me infrastrukturë ligjore shumë mirë të përcaktuar, do të qëndroj brenda saj se jam e bindur personalisht se gjërat kaq të rëndësishme shumë në mënyrë më serioze duhet me u diskutuar. Prandaj konsideroj joserioze pazarin në mes deputeteve për përqindjen e aksioneve që është jo bindëse dhe shije të keqe po lenë.

Sala Berisha Shala – të diskutohet që në rast të shitjes së aksioneve nga blerësi të pyetet Kuvendi.

Pas debatit të gjerë Komisioni më gjashtë (6) vota Për dhe tri (3) vota Kundër nxori këtë:

Rekomandim

1. Kuvendi të përkrah procesin e filluar të privatizimit të PTK-së për sektorin e telekomunikacionit duke bërë vlerësimet e veçanta të aseteve për Telekomin dhe Posten;
2. Kuvendi të lejoj shitjen deri në 59% të aksioneve të Telekomit për privatizim që siguron investitorin privat, kapitalin e tij, duke i mundësuar kontrollimin e menaxhimit dhe të vendimmarrjes në kompani për të realizuar strategjinë e zhvillimit të plotë të saj me konkurrencën dhe trendët në tregun e telekomunikacionit;
3. Kuvendi vlerëson se përmes këtij partneriteti dhe investimeve për 3-4 vitet e ardhshme në kompani, vlera e aksioneve të mbajtura 41-49 % nga Qeveria e Kosovës do të rriteshin me kalimin e kohës bashke me dividenden vjetore dhe benefitet tjera për shtetin;
4. Kuvendi obligon Qeverinë që mjetet nga shitja të përdoren për investime kapitale dhe zhvillim ekonomik të vendit. Deri në 50 % të lejohen për infrastrukture dhe Autostradën, ndërsa mjetet tjera të investohen në veprimtari dhe programe tjera ekonomike zhvillimore;
5. Kuvendi kërkon nga Qeveria të beje përgatitjet më kohë dhe deri në momentin e shitjes së aksioneve të aplikoj dhe të merr Kodin e telefonisë për Kosovën e cila do të ndikoj në rritjen e vlerës së PTK-së dhe çmimin e shitjes së aksioneve;
6. Kuvendi kërkon nga Qeveria të mundësoj procesin transparent, pa ndikime politike nga i cili do të varet edhe performanca e kompanive ofertuese dhe fituesit të tenderit;
7. Kuvendi kërkon nga Qeveria që në fazën e caktuar, të njoftoj lidhur me zbatimin e rekomandimeve, ecurinë, transparencën, kontratën dhe marrëveshjen në mbrojtjen e interesave të punëtorëve në PTK;

4. Të ndryshme

Çështje vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00

E përgatiti:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani